Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fillon bisedimet me fituesin për të sqaruar dhe për të përmirësuar kushtet e kontratës, metodologjinë, përbërjen e stafit dhe kushtet e veçanta. Bisedimet nuk duhet t'i ndryshojnë në mënyrë thelbësore kushtet fillestare të kontratës ose propozimin e përzgjedhur.

Oferta ekonomike nuk duhet të ndryshohet në asnjë rast.

- 24. Konvertimi në valutë të vetme**
1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

G. DHËNIA E KONTRATËS

- 25. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Propozimit, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Propozimi i tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

- 26. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve, Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen Kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

H. ANKESAT

- 27. Procedura e ankesës**
1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

I. ANULIMI I PROCEDURËS

- 28. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen

e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1:	Kërkesë për pjesëmarrje
Shtojca 2:	Ftesa për Propozim
Shtojca 3:	Formulari i Deklarimit të Propozimit
Shtojca 4:	Formulari i Propozimit Ekonomik
Shtojca 5:	Formulari i Sigurimit të Ofertës
Shtojca 6:	Lista e Informacionit Konfidencial
Shtojca 7:	Deklaratë për disponueshmërinë e stafit të konsulentit
Shtojca 8:	Formulari i Specifikimeve Teknike
Shtojca 9:	Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

- Shtojca 10: Formulari i Termave të Referencës
Shtojca 11: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
Shtojca 12: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të skualifikimit
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit
Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)
Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
Shtojca 17: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

KËRKESË PËR PJESËMARRJE

(Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i)

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Unë (Ne), të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për pjesëmarrje për këtë procedurë:

Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Datë

Shtojca 2

[Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti/enti kontraktor]

FTESË PËR PROPOZIM

(Vetëm për kandidatët e përzgjedhur pas shqyrtimit të kërkesave për pjesëmarrje)

[Data]

Për : [Emri dhe adresa e ofertuesit të përzgjedhur]

Procedura e Prokurimit: _____

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentave të paraqitura në fazën e pare, jeni kualifikuar për në fazën e e paraqitjes së propozimeve.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë _____ (emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor)

propozimin tuaj, duke marrë parasysh se:

Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e propozimit është :

Data, ora dhe adresa

Data: □□/□□/□□□□(d/m/v) ora □□:□□

Adresa: _____

Kur propozimi kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë propozimin në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

Informacioni mbi propozimet e paraqitura me mjete elektronike, i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar propozime, në bazë të kërkesës së tyre.

Gjuha(-ët) për hartimin e propozimeve janë:

Shqip Anglisht

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit :

Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik e financiar do të ftohet për negociata për lidhjen e kontratës.

Jemi në pritje të propozimit tuaj.

Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor

Shtojca 3

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I DEKLARIMIT TË PROPOZIMIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr. Referencës në faqen e APP-së

Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i

Unë (Ne), të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne [*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*], nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*].
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor [**vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor**], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për [**vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE**] në përputhje me grafikun e kërkuar të kryerjes së shërbimit.
- (d) Ne nuk marrim pjesë si kandidatë në më shumë se një propozim në këtë procedurë prokurimi.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike dhe termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

e) Çmimi Total i propozimit tonë është shprehur në propozimin ekonomik.

Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Datë

Shtojca 4

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

FORMULARI I PROPOZIMIT EKONOMIK

Tarifat sipas Kategorisë së Punës : (Nëntotali i detajuar)

Pagesat Ditore: (Nëntotali i detajuar)

Kostot e Drejtpërdrejta: (Nëntotali i detajuar)

Shpenzimet e Rimbursueshme: (Nëntotali i detajuar)

TOTALI

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]
Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]
Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]
Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit²**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Në bazë të parashikimeve të neneve 41 dhe 54 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, **me asnjë** nga anëtarët e stafit të autoritetit/entit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

² Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 9

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Hartimi i Masterplanit të Parkimit dhe planit të biznesit të Tirana Parking do të realizohet brenda afatit **prej 4 muajsh (16 javë) duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës** me subjektin e kontraktuar. Kontraktori duhet të parashikojë dhe detajojë në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdoshme deri në momentin final, atë të miratimit të dorëzimit të produktit final. Procesi i punës për hartimin e masterplanit dhe planit të biznesit do t'i përmbahet grafikut të zbatimit të aktiviteteve si vijon:

Afatet e ekzekutimit:

	Aktivitetet	Javë															
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	XIII	XIV	XV	XVI
Masterplani	Analiza e kuadrit ligjor teknik	■	■														
	Analiza e Gjendjes aktuale	■	■	■	■												
	Përcaktimi i Vizionit dhe objektivave					■											
	Identifikimi i ndërhyrjeve të propozuara				■	■	■	■									
	Plani i Investimeve kapitale							■	■	■	■						
	Plani i Implementimit									■	■	■	■	■			
Plani i biznesit	Prezantim i Përgjithshëm							■	■	■							
	Gjendja Aktuale							■	■	■	■	■					
	Vizioni dhe Objektivat							■	■	■	■	■					
	Plani i Investimeve kapitale										■	■	■				
	Të ardhurat dhe shpenzimet											■	■				

Struktura organizative																		
Plani i përmirësimit të performancës																		

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

”SHËRBBIME KONSULENCE PËR HARTIMIN E MASTERPLANIT TE PARKIMIT PUBLIK DHE PLANIT TË BIZNESIT PËR TIRANA PARKING”

1 Hyrje

Tirana Parking (TP) është krijuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 48, datë 11.11.2015, për “Krijimin e Tirana Parking si Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë për Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë”. Sipas këtij vendimi, fushat e përgjegjësisë së Tirana Parking janë administrimi i shërbimit të parkimit publik në rrugë dhe në sheshe, mbi dhe nëntokësore, planifikimi dhe zbatimi i investimeve në infrastrukturë, instalimi dhe mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore dhe makinerive të parkimit me pagesë, si edhe konstatimi dhe gjorbitja e kundravajtjeve administrative për mospagesë tarife apo qëndrim përtej orarit të caktuar në vendparkim.

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 49, datë 11.11.2015, për “Miratimin e Kritetereve të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzonave të Destinuara për Parkim, si dhe Tarifave të Shërbimit të Parkimit të Administruara nga Bashkia e Tiranës”, janë përcaktuar kriteret e Zonave të Administrimit të Parkimit (ZAP) dhe sistemi tarifor për parkimin në rrugë dhe në sheshe duke e ndarë Tiranën në zonat A, B dh C. Gjithashtu, ky vendim përcaktoi edhe katër ZAP duke caktuar për secilën prej tyre rrugët ku do të shtrihet parkimi me pagesë si edhe numrin e vendparkimeve që do të jenë me pagesë apo të lirë për rezidentët dhe personat me aftësi të kufizuara. Politika që do duhet të ndiqte Tirana Parking përmes sistemit tarifor dhe zonal të përcaktuar do të ishte favorizimi i parkimit afatgjatë në sheshe dhe i parkimit afatshkurtër në rrugë, sidomos në Zonën A ku edhe kërkesa për parkim është më e lartë.

Në përputhje me VKB nr. 49, datë 11.11. 2015, shërbimi i parkimit me pagesë do të shtrihet në total në 63 rrugë, nga të cilat 38 rrugë në Zonën A, 19 rrugë në Zonën B dhe 6 rrugë në Zonën C. Sa i përket parkimit të lirë në këto rrugë, Tirana Parking ngarkohej të pajiste me një kartë rezidenti të gjithë banorët e zonave, duke garantuar kështu parkimin e lirë për ta. Gjithashtu, Tirana Parking do të administronte edhe parkimet nëntokësore për të cilat po investonte Bashkia e Tiranës si edhe do të investonte përmes buxhetit të vetë në krijimin e sheshparkimeve të reja. Aktualisht TP administron 10 sheshe parkimi, nga të cilët 8 ndodhen në zonën A, 1 në zonën B dhe 1 në zonën C. Këto sheshe kanë në total kanë 2187 vendparkime, sipas specifikimeve të përmbledhura në tabelën e mëposhtme. Në total këto sheshparkime vizitohen nga një mesatare prej 3,017 automjeteve në ditë. Një tjetër përgjegjësi e Tirana Parking do të ishte administrimi i Terminaleve të përkohëshme të Transportit të Udhëtarëve të ndodhur përkatësisht pranë Pallatit të Sportit Asllan Rusi dhe pranë Qytetit Studenti.

2 Gjendja Aktuale dhe Nevoja për Shërbimin e Parkimit

Gjatë viteve të tranzicionit, Tirana gjithmonë e më shumë e ka vuajtur mbingopjen e automjeteve në lidhje me parkimin. Por, ndërkohë që pritshmëritë janë që numri i automjeteve të rritet akoma edhe më shumë në të ardhmen, nevoja për shtimin e hapësirave të parkimit dhe për kontrollin dhe rregullimin e atyre ekzistuese është bërë imediate. Aktualisht, në Bashkinë e Tiranës gjenden mbi 200,000 automjete ose rreth 250 automjete për 1,000 banorë. Ndërkohë, Tirana Parking administron në total 7270 parkime në rrugë, 1429 parkime në sheshe dhe 5841 parkime për rezidentë.

Politikat afatmesme dhe afatgjata të Bashkisë së Tiranës sa i përket transportit janë promovimi i menyrave alternative të transportit si transporti publik dhe lëvizja me biçikleta. Nisja e zbatimit të kësaj politike në disa prej rrugëve kryesore të zonës qendrore të Tiranës ka theksuar edhe më shumë problemet e hershme të mbingopjes së automjeteve të parkimit. Nga ana tjetër, vendosja e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugët kryesore dhe sekondare në brendësi të Unazës së Mesme ka lehtësuar qarkullimin dhe ka zgjidhur problemin e parakimit afatshkurtër, por, në të njëjtën kohë, e kanë kanalizuar kërkesën për parkim afatgjatë brenda blloqeve të banimit.

Nisur nga sa më sipër, Tirana Parking parashikon hartimin e një dokumenti strategjik i cili do të analizojë gjendjen aktuale dhe nevojat për parkim si edhe do të përcaktojë të gjitha hapat e zhvillimit të mëtejshëm të shërbimit të parkimit publik në Bashkinë Tiranë.

3 Masterplani i Parkimit

Hartimi i Masterplanit të Parkimit ka si qëllim që të vendosë në dispozicion të Tirana Parking, një dokument i cili përmban një analizë të të gjitha aspekteve të parkimit publik, në mënyrë që duke u bazuar mbi rezultatet e këtij studimi, Tirana Parking të ketë mundësi për vendimmarrje të mëtejshme, në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve të parkimit.

Objektivat kryesore strategjike të Masterplanit do të jenë:

1. Të mbulojë në mënyrë efëçente territorin e Bashkisë Tiranë me hapësira publike për parkim;
2. Të lehtësojë aksesin në parkim për qytetarët sa i përket parkimit afatshkurtër, parkimit afatgjatë dhe parkimit për rezidentët;
3. Të modernizojë administrimin e parkimit publik përmes futjes së teknologjive të reja.

Masterplani duhet të trajtojë, por jo të kufizohet, çështjet e mëposhtme:

3.1. Analiza e Gjendjes Aktuale

Analiza e gjendjes ekzistuese duhet të synojë identifikimin e sfidave dhe problematikave me të cilat përballet parkimi publik, duke u bazuar në elementët e mëposhtëm:

- Analiza e trafikut aktual për të përcaktuar llojet e udhëtimeve me automjet (për punë, për argëtim, etj.) si edhe vend-nisjet dhe vend-mbërritjet e këtyre udhëtimeve;
- Analiza dhe përcaktimi i kërkesës dhe ofertës për shërbimin e parkimit në qytetin e Tiranës;
- Identifikimi i zonave me kërkesë për parkim afat-shkurtër, parkim afat-gjatë dhe parkim për rezident;
- Analiza e shtrirjes aktuale të shërbimit të parkimit publik;
- Identifikimi i nevojave përsa i përket shërbimit të parkimit publik.

Analiza aktuale e trafikut duhet fillimisht të analizojë lëvizshmërinë dhe qarkullimin e qytetarëve të Tiranës duke prezantuar të dhëna mbi përdorimin e transportit publik, biçikletave, lëvizjes në këmbë dhe automjeteve. Më pas duhet përcaktojë llojet e udhëtimeve me automjet duke i kategorizuar sipas arsyes së udhëtimit dhe zonës specifike ku nisin dhe përfundojnë këto udhëtime. Vend-nisjet dhe destinacionet e udhëtimeve përcaktojnë edhe kërkesën për parkim.

Kërkesa dhe oferta për shërbimin e parkimit duhet të bazohet në analizën e trafikut. Për të kryer këtë analizë ekipi i konsulentëve duhet të mbledhë të dhëna të besueshme e zyrtare. Kërkesa për parkim duhet të bazohet në numrin e automjeteve në qarkullim dhe numrin e udhëtimeve ndërsa oferta në bazë të hapësirave të parkimit në dispozicion në zona të caktuara.

Identifikimi i zonave duhet të realizohet duke e ndarë territorin në zona rezidenciale, zona biznesi dhe zona shërbimesh apo rekreative. Volumi i udhëtimeve që nis e përfundon në këto zona duhet të analizohet në variacion të ditëve dhe orëve të caktuara. Në bazë të tipologjisë së zonës dhe udhëtimeve duhet të përcaktohet edhe lloji i parkimeve që ka kërkesën më të lartë në secilën zonë.

Në bazë të analizës së mësipërme duhet të identifikohen edhe **problemet dhe sfidat** me të cilat përballet parkimi publik në Bashkinë Tiranë.

Për përmbushjen e detyrave të mësipërme, ekipi i konsulentëve mund të bazohet në studime të mëparshme, të dhënat zyrtare mbi transportin rrugor të publikuara nga insitucionet publike si edhe në kryerjen e matjeve dhe vrojttimeve specifike.

3.2. Vizioni dhe Objektivat

Bazuar në analizën e gjendjes aktuale duhet të përcaktohet vizioni dhe objektivat strategjike të Masterplanit. Këto duhet të jenë në përpupthje me misionin dhe objektivat e Bashkisë së Tiranës dhe Tirana Parking.

3.3. Ndërhyrjet e Propozuara

Duke u bazuar në analizën e gjendjes aktuale dhe nevojat e identifikuar, ekipi i konsulentëve duhet të propozojë ndërhyrje specifike për adresimin e këtyre nevojave. Këto ndërhyrje duhet të jenë në përpupthje me legjislacionin në fuqi sa i përket zonimit parkimit dhe ndarjes së vend-parkimeve në secilën rrugë. Ndërhyrjet duhet të përfshijnë, por jo të kufizohen, në elementët e mëposhtëm:

- Identifikimi i rrugëve të reja ku mund të shtrihet shërbimi i parkimit me pagesë;
- Identifikimi i zonave të reja ku mund të shtrihet shërbimi i parkimit për rezidentë;
- Identifikimi i zonave që mund të kthehen në sheshe parkimi;
- Identifikimi i zonave ku mund të ndërtohen parkime nëntokësore.

Në identifikimin e zonave duhet t'i jepet përparësi përzgjedhjes së trojeve në pronësi publike duke shmangur sa më shumë të jetë e mundur shpronësimin.

3.4. Plani i Investimeve Kapitale

Për ndërhyrjet e propozuara të cilat do të miratohen nga Tirana Parking, ekipi i konsulentëve duhet të hartojë projekt-idene arkitektonike si edhe të përcaktojë kostot e nevojshme. Përlllogaritja e kostove duhet të bëhet në përpupthje me çmimet e tregut dhe në zbatim të Manualit të Ndërtimit të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës. Projektet dhe preventivat paraprake duhet të përmbliken në një Plan të Investimeve Kapitale i cili duhet të jetë një pjesë integrale e Masterplanit.

3.5. Plani i Implementimit

Plani i Implementimit duhet të paraqesë kohën e identifikuar për implementimin e secilës ndërhyrje duke përfshirë edhe shpenzimet e nevojshme kapitale dhe identifikimin e strukturës përgjegjëse. Plani i Implementimit duhet të hartohet duke patur parasysh resurset aktuale dhe resurset e pritshme në dispozicion të Tirana Parking.

4 Plani i biznesit

Hartimi i planit të biznesit, ka si qëllim që të vendosë në dispozicion të Tirana Parking, një dokument të detajuar që përmban strategjinë dhe parashikimet financiare të aktivitetit të Tirana Parking. Ky dokument do të përcaktojë kapacitetet e përballimit të angazhimeve financiare për zgjerimin e shërbimeve të parkimit. Plani i biznesit për funksionimin e Tirana

Parking do të hartohet bazuar në përvojat dhe standartet më të mira të fushës. Plani i biznesit duhet të përmbajë dhe trajtojë çështjet si më poshtë:

4.1. Prezantimi i Përgjithshëm i Tirana Parking

Plani i Biznesit duhet të nisë me një prezantim të përgjithshëm të Tirana Parking duke analizuar fushën e veprimtarisë, analizën e legjislacionit përkatës, përmbushjen e misionit dhe objektivat, të dhëna mbi punën dhe performancën e deritanishme, identifikimin e arritjeve si edhe përcaktimin e sfidave dhe problematikave të caktuara.

4.2. Gjendja Aktuale

Seksioni i analizës së gjendjes aktuale duhet të përmbajë tre nën-seksione:

- Shtrirja e shërbimit të parkimit publik;
- Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Identifikimi i nevojave.

Ky seksion do të përgatitet në përputhje me seksionin mbi analizën e gjendjes aktuale në dokumentin e Masterplanit, por duke i kushtuar një vëmendje më të madhe veprimtarisë së Tirana Parking si edhe treguesve financiarë të institucionit.

Gjendja aktuale duhet të marrë në konsideratë shtrirjen e shërbimit të parkimit publik me pagesë në përputhje me parashikimet e VKB Nr. 49, datë 11.11.2015, performancës deritanishme të Tirana Parking në administrimin e parkimit në rrugë dhe sheshe, efektivitetin në administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Gjithashtu, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe identifikimit të nevojave sa i përket qoftë shërbimit të parkimit ashtu edhe të institucionit.

4.3. Vizioni dhe Objektivat

Deklarata e vizionit dhe objektivat strategjike duhet të përfshijnë parashikimet e Tirana Parking sa i përket shtrirjes së shërbimit të parkimit, përmiresimit të shërbimeve për qytetarët, riorganizimit të brendshëm për të përdorur më me efektivitet resurset në nevojë, etj.

Ekipi i konsulentëve duhet të analizojë e propozojë skenarë alternative të organizimit të brendshëm të Tirana Parking që do të mundësonin një efektivitet më të lartë në ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët duke përdorur në mënyrë më eficiente resurset në dispozicion.

4.4. Plani i Investimeve Kapitale

Plani i investimeve kapitale duhet të përfshijë investimet e parashikuara në infrastrukturë, por edhe investime në konsulencë, teknologji dhe burime njerëzore. Plani i shpenzimeve kapitale duhet të garantojë përmbushjen e vizionit dhe objektivat strategjike të institucionit. Ky plan duhet të shoqërohet me një kostim të detajuar të secilit shpenzim në përputhje me çmimet e

tregut. Ekipi i konsulentëve duhet gjithashtu të identifikojë/propozojë burimin e mundshëm të financimit për secilin investim.

4.5. Të ardhurat dhe Shpenzimet

Projeksioni i të ardhurave dhe shpenzimeve duhet detajojë ndryshimet e pritshme në nivelin e të ardhurave dhe shpenzimeve që do të shkaktohen nga implementimi i planit të investimeve kapitale dhe riorganizimit të brendshëm të institucionit. Përlllogaritja duhet të bazohet në praktikat më të mira e më të gjithëpranuara financiare.

Përveç projeksioneve të të ardhurave dhe shpenzimeve, ekipi i konsulentëve duhet të përgatisë Buxhetin Operacional afatmesëm si edhe të përlllogarisë treguesit e rëndësishëm financiarë, si: norma e brendshme e kthimit, kostot e ponderuar e kapitalit apo vlera aktuale neto.

4.6. Struktura Organizative

Bazuar në parashikimet e Masterplanit dhe Planit të Biznesit, ekipi i konsulentëve duhet të propozojë një strukturë të re organizative për Tirana Parking, e cila do të mundësojë përmbushjen e vizionit dhe objektivave strategjike. Parimet e përgjithshme mbi të cilat duhet të bazohet struktura e re organizative do të jenë:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit për qytetarët duke përmirësuar prezencën dhe reagueshmërinë;
- Përcaktimi i saktë i roleve dhe përgjegjësive duke shmangur mbivendosjen e fushave të përgjegjësive;
- Ngritja e një strukture fleksible dhe efiçente.

Ekipi i konsulentëve duhet të përlllogarisë edhe kostot operacionale të ndryshimeve strukturore të propozuara.

4.7. Plani i Përmirësimit të Performancës

Për të garantuar një administrim sa më efiçent të Tirana Parking, objektivat strategjike të propozuara në Masterplanin dhe në Planin e Biznesit duhet të përkthehen në aktivitete konkrete e veprime specifike me tregues të matshëm të performancës për secilin prej tyre. Për secilin objektiv strategjik duhet të identifikohen aktivitetet që do të çojnë në implementimin e tyre të plotë, shpenzimet e nevojshme kapitale për secilin aktivitet si edhe treguesit periodikë të matjes së performancës.

5 Marrëveshja e menaxhimit

Konsulenti do të jetë përgjegjës për menaxhimin e procesit të detyrave, burimeve njerëzore, logjistikës dhe shpenzimeve të lidhura me detyrat në aspektin kohor dhe përshtatshmërinë në konsultime të ngushta me Tirana Parking. Procesi i përgjithshëm do të mbikëqyret nga Drejtoria e Administrimit të Parkimit Publik me Pagesë Raportimi dhe monitorimi i progresit të punës do të mbahet me operatorin në baza të rregullta.

6 Mënyra e dorëzimit të shërbimit.

Dorëzimi i projektit të zbatimit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Ato duhet të jenë të firmosura dhe të vulosura në origjinal nga konsulenti. Bashkengjitur me projektin duhet të sillen dhe miratimet e mundshme të Pushtetit Lokal, Drejtorise së Transporteve ose të institucioneve të që kanë bashkëpunuar dhe që janë pjesëmarrës dhe aktorë në këtë projekt.

Konsulenti duhet të dorëzojë në rrugë zyrtare në Tirana Parking 3 (tre) kopje të draft projektit dhe masterplanin të hartuar në formatin (A-3 deri A-1) 4, jave para përfundimit të afatit, dhe do të prese vrjetjet e Autoritetit Kontraktor.

Mbas reflektimit të vërejtjeve të dhëna nga Tirana Parking mbi draft raportin e parqitur, Konsulenti do të dorëzojë autoritet kontraktor raportin përfundimtar të shoqëruar me masterplanin përfundimtar.

Projekti do të dorëzohet në formë të shkruar në 5 (pesë) kopje të firmosura në origjinal dhe në formatet e kërkuara (A-3 deri A-1). Raporti do të dorëzohet në format A4.

Studimi do të dorëzohet në dy kopje elektronike (në disk) në formatin origjinal të punuar ose kompatibël me programet AutoCad, etj.

Përveç kësaj Konsulenti do të përgatisë një kopje elektronike të projektit në format PDF dhe Power Point, në mënyrë që të prezantojë punën e tij.

7 Referenca ligjore

- Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet Rrugore” (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetqëverisjen vendore”, (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar);
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar);
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 153 datë 07.04.2000 “Per miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”;
- Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 160, datë 21.12.2018, “Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë 2018-2022”;
- Vendim i Këshillit Bashkiak Nr. 83, datë 29.12.2016 dhe Vendimi i KKT Nr. 1, datë 14.04.2017 “Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor, Bashkia Tiranë”, (i ndryshuar);
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 48, datë 11.11.2015 “për Krijimin e Tirana Parking si Institucion në Varësi të Bashkisë Tiranë për Administrimin e Shërbimit të Parkimit Publik me Pagesë” (ndryshuar me VKB Nr. 36, datë 29.03.2018);

- Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 49, datë 11.11.2015 “Miratimin e Kritereve të Përcaktimit të Zonave të Administrimit të Parkimit dhe Nënzoneve të Destinuara për Parkim, si dhe Tarifave të Shërbimit të Parkimit të Administruara nga Bashkia e Tiranës”;
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 26.12.2019 “për Miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”.
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 26.12.2019 “për Miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”.

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit³.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

c. *Deklaratë për disponueshmërinë e stafit të konsulentit sipas Shtojcës 7*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të zotërojë licencat profesionale të mëposhtme:

a) Licënsa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:

Kategoria 1. PROJEKTIM URBANIST

³ Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të secilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

c- Plane të detajuara vendore.

Kategoria 2. PROJEKTUES ARKITEKT

a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.

Kategoria 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a- Projektim objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate

Kategoria 6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

a- Projektim rruge lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka në dispozicion burime njerëzore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të kontratës.

a) Për përmbushjen e këtij kriteri, numri mesatar i të punësuarve duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë), vërtetuar me:

- Vërtetim lëshuar nga Administrata Tatimore, ku specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3(tre) muajt e fundit (duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave).

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi (formularët E-sig 025) për periudhën 3 (tre) muajt e fundit (duke marrë si referencë datën e hapjes së ofertave).

b) Konsulenti duhet të ketë në përbërje staf pune të kualifikuar për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe planit të biznesit. Operatori ekonomik të ketë një Ekip të përbërë nga Ekspertë me eksperiencë të ngjashme në fushat respektive të ekspertizës, si më poshtë:

1) 1 (një) Ekspert kryesor/ Menaxher projekti

Diplomë universitare në nivel Master në fushat e ngjashme me shërbimet e kërkuara si, ekonomi apo agro-biznes. Të ketë të paktën 7 (shtatë) vjet eksperiencë pune, përbën avantazh me njohuri dhe eksperiencë të mëparshme në nivel menaxherial në koordinim dhe implementim projektesh, si hartimi i masterplaneve, studimeve të fizibilitetit apo planeve të biznesit. Të ketë njohuri të mira të organeve të qeverisjes vendore.

2) 1 (një) Ekspert i Transportit

Diplomë universitare në nivel Master në Inxhinieri Mekanike, Planifikim Urban ose në ndonjë fushë tjetër të ngjashme. Të ketë të paktën 7 (shtatë) vjet përbën avantazh eksperiencë profesionale në hartimin e studimeve në fushat e transportit dhe trafikut.

3) 1 (një) Ekspert i Ekonomisë

Diplomë universitare në nivel Master në Ekonomi, Informatikë Ekonomike ose në ndonjë fushë tjetër të ngjashme. Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përbën avantazh eksperiencë profesionale, të tilla si, hartimi i planeve të biznesit/ studimeve të fizibilitetit, projeksionet e të ardhurave e shpenzimeve, etj të ngjashme me to.

4) 1 (një) Inxhinier Ndërtimi

